ALBANSKA

Shkurtimisht mbi arsimin e mesëm suedez

Skolverket

Të gjithë të rinjtë në Suedi të cilët e kanë përfunduar shkollën fillore kanë të drejtë për arsim të mesëm trevjeçar. Arsimi i mesëm jep një bazë të mirë për veprimtari profesionale, studime të vazhduara, zhvillim personal dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore.

18 programe nacionale

Ligji shkollor që hyri në fuqi më 1 korrik 2011 i barazon shkollat e mesme të pavarura me ato publike.

Ka 18 programe nacionale në arsimin e mesëm, 12 programe profesionale dhe 6 programe përgatitore për studime universitare. Të gjitha programet e arsimit të mesëm janë trevjeçare.

Pas një programi profesional nxënësit duhet të jenë mirë të përgatitur për jetën profesionale dhe shkollimi duhet të mbajë cilësi të mirë e të rezultojë në zotësi brenda profesionit. Pas shkollimit duhet të jetë e mundshme që menjëherë të fillohet vija profesionale. Të gjithë nxënësit në një program profesional kanë gjithashtu mundësi që gjatë shkollimit të mesëm të arrijnë kualifikim themelor për studime universitare. Që të arrihet kjo kërkohet që nxënësi të zgjedhë kurse të cilat japin kualifikim themelor për studime universitare.

Pas programit përgatitor për studime universitare nxënësit duhet të jenë të përgatitur për studime universitare.

Përveç kësaj ka pesë programe introduksioni për nxënës të cilët nuk janë të kualifikuar për ndonjë program nacional. Programet e introduksionit duhet t'i bartin nxënësit drejt ndonjërit nga 18 programet nacionale ose drejt jetës punonjëse.

Në disa shkolla ka shkollime të cilat devijojnë nga programet nacionale: variante të veçanta, shkollime mbarështetërore rekrutuese dhe programe nacionale të pranuara të sportit (NIU).

Kushtet e kualifikimit për arsim të mesëm

Rregullat e kualifikimit për fillim të vijimit të shkollimit të mesëm ndryshojnë ndërmjet programeve profesionale dhe programeve përgatitore për studime universitare.

Për pranim në ndonjë program nacional, pa marrë parasysh nëse është program profesional ose program përgatitor për studime universitare, nxënësi duhet të ketë notë të mjaftueshme në suedishte, suedishte si gjuhë të dytë, anglishte dhe matematikë.

Për programet profesionale kërkohet veç kësaj notë e mjaftueshme edhe në pesë lëndë të tjera, do të thotë gjithsejt tetë.

Për programet përgatitore për studime universitare kërkohet veç kësaj notë e mjaftueshme edhe në nëntë lëndë të tjera, do të thotë gjithsejt dymbëdhjetë.

Për programin ekonomik dhe atë të shkencave shoqërore si dhe për programin e humanistikës, katër nga lëndët e tjera me notë të mjaftueshme duhet të jenë gjeografia, historia, dituri shoqërie dhe dituri fetare. Për programin e shkencave natyrore dhe programin teknologjik tre nga lëndët e tjera me notë të mjaftueshme duhet të jenë biologjia, fizika dhe kimia. Për programin e estetikës nëntë nga lëndët e tjera janë të zgjedhshme.

Disa shkollime brenda lëmit të estetikës, shkollime kulmore dhe programe të sportit, mund të kenë kushte të veçanta të pranimit dhe ndonjëherë testime.

Kurset dhe planet lëndore

Arsimi i mesëm suedez është i ndërtuar në bazë të kurseve. Kjo do të thotë se nxënësit mësojnë nga një ose më shumë kurse brenda lëndëve të ndryshme që hyjnë në program. Shumica e kurseve përfshijnë nga 100 pika, të cilat janë sa rreth katër javë studime të rregullta. Lëndët e arsimit të mesëm dhe përmbajtjet e kurseve të ndryshme si dhe kushtet e diturisë përshkruhen në planet lëndore nga të cilat drejtohet arsimi.

Shkalla e notave

Shkalla e notave i përmban shenjat A-F, ku A është nota më e lartë dhe E është nota më e ulët e mjaftueshme. F do të thotë i pamjaftueshëm. Nxënësit i jepen nota pas çdo kursi të përfunduar. Ekzistojnë kushte nacionale të diturive për shkallat e notave E, C dhe A.

Struktura e programeve

Lëndët e përbashkëta të arsimit të mesëm janë lëndë të cilat mësohen nga të gjithë nxënësit e shkollës së mesme. Këto janë anglishtja, historia, edukata fizike, matematika, dituri natyre, dituri fetare, dituri shoqërore dhe suedishtja ose suedishtja si gjuhë e dytë. Nxënësit i mësojnë lëndët e përbashkëta të arsimit të mesëm në masa të ndryshme në programet e ndryshme.

Përveç lëndëve të përbashkëta të shkollës së mesme secili program përmban një numër **lëndësh të përbashkëta për programin**, të cilat mësohen nga të gjithë nxënësit në një program të caktuar. Këto e caktojnë karakterin e programit.

Të gjitha programet përveç programit të shëndetësisë dhe përkujdesjes kanë **drejtime** të ndryshme mes të cilave munden të zgjedhin nxënësit. Veç kësaj në çdo program ka kurse të ndryshme të thellimit programor. Në shkollim përfshihet po ashtu një zgjedhje individuale.

Branda **zgjedhjes individuale** në programet profesionale, shkolla duhet të ofrojë kurse të cilat nevojiten për kualifikim themelor për studime universitare. Në të gjitha programet nxënësit duhet të kenë mundësi të mësojnë së paku nga një kurs të estetikës dhe së paku nga një kurs të edukatës fizike brenda zgjedhjes individuale.

Në arsim në të gjitha programet përfshihet po ashtu një **punim përfundimtar gjimnazial**, i cili e përmbledh shkollimin në atë program. Punimi përfundimtar gjimnazial duhet të kalohet me notë të mjaftueshme, që nxënësi të marrë diplomë.

Arsimi shegertor

Brenda programeve profesionale është mundshme të zgjidhet arsimi i mesëm shegertor. Nxënësi i cili zgjedh të shkojë në arsim shegertor e vijon pjesën më të madhe të shkollimit në një ose disa vende pune. Synimet dhe kushtet e diturisë për arsimin shegertor janë të njejta si ato për arsimin nëpër shkolla.

Për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet programeve profesionale të arsimit të mesëm dhe jetës punonjëse ka këshille programore nacionale dhe lokale.

Dy lloje diplomash

Nxënësi i cili përfundon një program të arsimit të mesëm mundet të marrë diplomë të shkollës së mesme.

Për **diplomë profesionale** kërkohet që nxënësi të ketë mësuar 2500 pika nga të cilat 2250 me notë të mjaftueshme. Nxënësi duhet të ketë notë të mjaftueshme në suedishte 1, alternativisht suedishte si gjuhë të dytë 1, anglishte 5 dhe matematikë 1. Një kusht është po ashtu që nxënësi të ketë notë të mjaftueshme në 400 pika nga lëndët e përbashkëta për programin dhe notë të mjaftueshme në punimin përfundimtar gjimnazial. Nxënësi mundet të fitojë diplomë profesionale qoftë nëpërmjet arsimit shegertor e qoftë nëpërmjet arsimit që mbahet nëpër shkolla.

Për **diplomë përgatitore për studime universitare** kërkohet që nxënësi të ketë mësuar 2500 pika nga të cilat 2250 me notë të mjaftueshme. Nxënësi duhet të ketë notë të mjaftueshme në suedishte 1, 2 dhe 3, alternativisht suedishte si gjuhë të dytë 1, 2 dhe 3, anglishte 5 e 6 dhe matematikë 1. Përveç kësaj nxënësi duhet të ketë notë të mjaftueshme në punimin përfundimtar gjimnazial.

Diploma përgatitore për studime universitare jep kualifikim themelor për studime universitare.

Lexo më shumë për kualifikimin për studime universitare në www.skolverket.se nën *Förskola & skola* (Parashkollorja & shkolla) Pastaj *Gymnasieutbildning* (Arsimi i mesëm)

Edhe diploma profesionale si dhe notat e mjaftueshme në suedishte 2 e 3, alternativisht suedishte si gjuhë e dytë 2 e 3, dhe anglishte 6, jep po ashtu kualifikim themelor për studime universitare.

Të gjithë nxënësit në programet profesionale kanë të drejtë t'i mësojnë ato kurse që nevojiten për kualifikim themelor për studime universitare.

Përveç kualifikimit themelor shpesh kërkohen nota të mjaftueshme në kurse që kanë rëndësi të veçantë për shkollimin e kërkuar, i ashtuquajturi kualifikim i veçantë.

Nxënës i cili nuk i ka arritur kushtet për diplomë të shkollës së mesme në vend të diplomës duhet të marrë një certifikatë studimore.

Ndërmarrësia

Ndërmarrësia duhet ta përshkojë tërë arsimin e mesëm. Në të gjitha programet ka mundësi për nxënësit që të thellohen në ndërmarrësi.

Një pjesë e Evropës

Arsimi i mesëm suedez ka lidhje me sistemet evropjane të kualifikimit. Synimi është që të mbështetet lëvizshmëria e qytetarëve ndërmjet shteteve dhe që të lehtësohet nxënia e përjetshme.

Arsimi për të rritur

Arsimi për të rritur duhet t'i përdorë planet lëndore dhe kushtet e diturisë të arsimit të mesëm. Njëkohësisht arsimi për të rritur duhet të jetë fleksibël dhe të u përshtatet nevojave të nxënësve të rritur.

18 programet

Programet profesionale

- Programi për punë me fëmijë dhe kohë të lirë – *Barn- och fritidsprogrammet*
- Programi i ndërtimtarisë – *Bygg- och anläggningsprogrammet*
- Programi i elektroenergjetikës – *El- och energiprogrammet*
- Programi i automjeteve dhe transportit – *Fordons- och transportprogrammet*
- Programi i tregtisë dhe administrimit – *Handels- och administrations-programmet*
- Programi i zejtarisë – *Hantverksprogrammet*
- Programi i hotelierisë dhe turizmit – *Hotell- och turismprogrammet*
- Programi industrialo-teknologjik – *Industritekniska programmet*
- Programi i resurseve natyrore – *Naturbruksprogrammet*
- Programi restoranto-ushqimor – *Restaurang- och livsmedelsprogrammet*
- Programi për punë hidraulike, ventilimi, saniteti dhe mirëmbajtje ndërtesash – *VVS- och fastighetsprogrammet*
- Programi për shëndetësi dhe përkujdesje – *Vård- och omsorgsprogrammet*

Programet përgatitore për studime universitare

- Programi i ekonomisë – *Ekonomiprogrammet*
- Programi i estetikës – *Estetiska programmet*
- Programi i humanistikës – *Humanistiska programmet*
- Programi i shkencave natyrore – *Naturvetenskapsprogrammet*
- Programi i shkencave shoqërore – *Samhällsvetenskapsprogrammet*
- Programi i teknologjisë – *Teknikprogrammet*

Programet e introduksionit

Pesë programet e ndryshme të introduksionit duhet të u japin mundësi të reja nxënësve pa kualifikim. Nëpërmjet programeve nxënësi mundet të fitojë kualifikim për ndonjë program nacional, të përgatitet për tregun e punës ose të vazhdojë më tutje në ndonjë shkollim tjetër.

Pesë programet e introduksionit janë

- Shkollimi përgatitor – *Preparandutbildning*
- Zgjedhje individuale me orientim programor – *Programinriktat individuellt val*
- Introduksion profesional – *Yrkesintroduktion*
- Alternativë individuale – *Individuellt alternativ*
- Introduksion gjuhësor – *Språkintroduktion*

ISBN: 978-91-86529-74-1
Grafisk form: AB Typoform
Foto: Michael McLain

Skolverket